

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar qytetarë,

Sot do të jetë një nga fjalët e mia më të shkurtra që kam mbajtur ndonjëherë në këtë foltore të Kuvendit të Shqipërisë, jo sepse nuk kemi pasur seanca me një argument që i vinim rrotull apo nuk kemi pasur seanca me sallë bosh, por besoj se seanca e sotme është pa çështje. Përshtypja ime është që seanca e sotme u ngeli në dorë kërkuesve të saj.

Dikush e nisi herët kërkesën, si për të marrë flamurin dhe pastaj filloi vrapin dhe gara brenda opozitës, se kush e kush të bënte më shumë, të kërkonte më shumë, të justifikonte më shumë. Filluan me interpelancën, me pyetjet, me mocionin për debat, me komisionin hetimor, me revolucione, me protesta me çështje të cilat do t'u bëheshin të qarta njerëzve. "Na u mbars mali", tha një koleg. Po çfarë polli sot? Polli përsëri që edhe në këtë seancë nuk u tha asgjë, me qëllim që të vërtetat e mëdha të thuheshin kur të ngrihet komisioni hetimor. Po i njëjti avaz që ka filluar prej dymuajsh, që na mban të ngërthyer të gjithëve bashkë me orë, me ditë dhe me javë të tëra debatesh shterpë dhe prezencash analistësh nëpër studio. Kudo ku jemi ndodhur, jemi detyruar të flasim për një temë që s'ka çështje. Sot m'u krijua përshtypja që ky krahu këtej po ndien rrezikun anglo-amerikan për përçarjen e tij. U tha këtu që ne, Kryeministri Rama, s'ka lënë gurë pa lëvizur nëpërmjet këtij personit, që t'i bëjë gjëmën opozitës. Po mirë, ne kemi një çikë histori, apo jo? Kemi një çikë memorie. A ju kujtohet ajo shprehja: "Mos i bëj tjetrit atë që s'do të ta bëjnë ty"? Nga t'ia filloj? Nga burgosja e liderit tonë? Nga fakti që nuk na linit të bënim asnjë lloj proteste? Nga fakti që na masakruat duke na vlarë? Nga se? Apo t'ju kujtoj ligjin e famshëm që bëtë, me të cilin i hoqët të drejtën shumicës së kupolës drejtuese të Partisë Socialiste që të kandidonte në zgjedhje? Këto janë veprime konkrete për t'i bërë dëm opozitës. Këto janë veprime konkrete për ta shkatërruar dhe për ta përçarë opozitën. Të gjithë ata që kanë një memorie politike e dinë shumë mirë që nuk kanë munguar këto veprime, kanë qenë prezente. Po mirë, pse del kjo temë si çështja e ditës? Pse e merrni dhe e rrokni kaq fort? Sigurisht, individë të caktuar brenda jush mund të kenë qëllimet e tyre, e kemi thënë, e kanë thënë, është diskutuar, është stërthënë, por unë nuk do të merrem me këtë, sepse nuk është në tagrin tim, edhe sepse premtova që do të flas shkurt.

Personalisht, besoj se po të mos ishte kjo çështje, një çështje tjetër do të gjenit, sepse një hall tjetër është përpara jush, është 14 maji dhe ju jeni të paorganizuar, jeni të papërgatitur, për t'u përballuar me betejën e radhës. Ju e dini shumë mirë që do të humbisni për të disatën herë përsëri dhe po përgatisni alibinë e radhës. Duke qenë i bindur se kjo është arsyeja kryesore, unë, ju lë takim më 14 maj! Faleminderit!